



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 24, paragrafit 1 dhe 2, lidhur me nenin 25, te Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”, e konform nenit 29, lidhur me nenin 31, të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 15 dhe 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

Neni 1

MIRATOHET; propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale me pronën e paluajtshme private për interes publik.

1.1 Prona e paluajtshme komunale e cila i **jepet** në emër të këmbimit personave fizik janë: 1. Agron (Hajrush) Berisha, 2. Malush (Beqir) Berisha, 3. Jakup (Muharrem) Berisha, 4. Sherif (Sejfulla) Berisha, 5. Mehdi (Muharrem) Berisha, 6. Ismet (Hasan) Berisha, 7. Skender (Sylejman) Berisha, 8. Tahir (Shaban) Berisha, 9. Enver (Sylejman) Berisha. 10 Hamdi (Avdi) Hoti që të gjithë nga Suhareka, është: **Parcela** kadastrale me **P-72116046-00805-0** sipas certifikatës së pronës Nr.1661/2024 e datës 13.05.2024, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Fshat” e evidentuar në emër të “Pasuri Shoqërore Rrugët”, me sipërfaqe të përgjithshme prej **854m²** nga sipërfaqja e përgjithshme për këmbim jepen përkatësisht **120m²** në posedim të personave fizik të lartcekur.

1.2 **Ndërsa** prona e paluajtshme private e cila merret në emër të këmbimit në posedim të Komunës së Suharekës është; Pjesa e parcelës kadastrale me **P-72116046-02978-0** sipas certifikatës së pronës Nr.1661-2024 e datës 13.05.2024, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Fshat” e evidentuar në emër të bashkëpronareve: 1. Agron (Hajrush) Berisha, 2. Malush (Beqir) Berisha, 3. Jakup (Muharrem) Berisha, 4. Sherif (Sejfulla) Berisha, 5. Mehdi (Muharrem) Berisha, 6. Ismet (Hasan) Berisha, 7. Skender (Sylejman) Berisha, 8. Tahir (Shaban) Berisha, 9. Enver (Sylejman) Berisha. 10 Hamdi (Avdi) Hoti që të gjithë nga Suhareka, me sipërfaqe të përgjithshme prej **6186m²** nga sipërfaqja e përgjithshme këmbimi bëhet për **144m²**.

Neni 2

Këmbimi i pronës se paluajtshme është bërë pasi që nuk ekziston parcelë tjetër komunale të përshtatshme për realizimin e “Planit zhvillimor komunal në Suharekë” dhe “Hartës Zonale të Komunës”, konkretisht **“Rregullimi infrastrukturës në rrugën Mulla Nura dhe Gjergje Fishta”** në qytetin e Suharekës.

Neni 3

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, që të zhvilloj të gjitha procedurat ligjore, konform dispozitave të nenit 25, të Ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 10/2019.

Neni 4

Prona e këmbyer nga personi Juridik dhe personat fizik të cekur në neni 1, të këtij vendim mundet të bartet në librat kadastral, pas lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës në mesë Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës kadastrale që këmbehet, me të cilën përcaktojnë kushtet, kriteret dhe mënyrën e bartjes.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër e Komunës së Suharekës.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI